



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 42

Datë: 25. 08. 2017, ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Ilir Gashi, anëtar i KQZ-së.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP.

Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Ilir Gashi, kryesues i mbledhjes.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.34-41/2017:

2. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- Këshilli për Buxhet:

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transferim të mjeteve nga programi i zgjedhjeve;

-Shqyrtimi i raportit të gjashtëmuorit të shpenzimeve të KQZ-së;

-Shqyrtimi i raportit vjetor të subjekteve politike të viti 2016;

-Propozim - ndryshimin i vendimit për mbushje të telefonisë mobile për zgjedhje lokale 2017.

- Këshilli për Operacione Zgjedhore:

-Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit për vula të fletëvotimeve;

-Shqyrtimi dhe miratimi i Formës së Përputhjes së të Dhënave (FPR);

-Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më datën 11 qershor 2017;

3. Të ndryshme;

1.Hyrje: z. Ilir Gashi, kryesues i mbledhjes.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KOZ-së nr.34-41/2017

Ilir Gashi: Në bazë të autorizimit që ka bërë kryetarja për të udhëhequr këtë mbledhje, më ka caktuar mua që ta udhëheq në emër të saj. Rendin e ditës gjith e keni para veti që nëse ka dikush të shtojë apo të heq në lidhje me rendin e ditës le të urdhëron. Urdhëro Ercan.

Ercan Shpat: Faleminderit kryesues, unë vetëm pata me ndryshuar një çështje në lidhje me certifikim të kandidatëve, nëse ka mundësi...

Betim Gjoshi: Unë e kam për pikë të rendit të ditës edhe mendoj që kishte me qenë mire para raportit të këshillave me diskutuar, dhe mendoj që është më sensitive...Ka të bëjë me numrin e asambleistëve të komunës së Vushtrisë. Ju siç jeni në dijëni, edhe me shumë vonës Ministria e Pushtetit Lokal na ka sjell 3-4 dit para dorëzimeve para certifikim një vendim, ku ka ndryshuar asambleistët e komunës së Vushtrisë. Edhe pse nuk ka ndodhur ndonjë fakt as juridik as politik as teknik nga zgjedhjet 2013 ju ka zvogëluar numri i asambleistëve dhe siç jeni në dijëni qe nja javë ka hasur jashtë zakonisht problem në komunën e Vushtrisë. Unë, fillimisht mendoj që subjektet politike kanë nominuar kandidatët, po aq sa ka qenë lista mandej...Unë, mendoj që nëse doni me arsyetuar pikën ose ndoshta nuk po e konsumoj, flas kur të vjen... por, ky është qëllimi me fol rreth saj për mënyrën qysh p'i qasemi na si Komision Qendror Zgjedhor...Është njoftuar zyra ligjore, edhe drejtoresha e zyrës për regjistrim të partive politike dhe, krejt akterët e tjerë...Por, na duhet me marr një veprim si Komision Qendror Zgjedhor pa dashur... kemi hyrë palë në këtë lojë, kështu që unë kisha kërkuar me qenë si pikë e rendit të ditës...

Ilir Gashi: Faleminderit, urdhëro Eshref.

Eshref Vishi: Sa i përket rendit të ditës unë kam një vërejtje te procesverbalet. Unë kam para vetit shtatë, nëse i keni edhe ju të tillë? Unë jam kundër kësaj pike të rendit të ditës nuk i kam lexuar fare, te kjo pikë e rendit të ditës nëse hyn jam kundër.

Bajram Ljatifi: Procesverbalet duhet të tërhiqen, edhe për një arye tjetër, jo për faktin se ne nuk i kemi lexuar...Proceverbalet, kanë gabime në data...Bëhet fjalë për procesverbalin nr. 39, dhe 40. Sekretariati, le t'i tërheqë dhe le ti sjellë në mbledhjen e radhës, dhe të mos përsëriten gabimet...

Binak Vishi: Kryesues a bën, edhe propozoj një pikë të tret të rendit të ditës që ka me qenë me bo me vendimet që merr Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që po ju ndërrohet forma dhe po ju ndërrohet materja atëhere kisha propozuar të jetë pikë e veçantë të rendit të ditës për të diskutuar më gjerë e mos me ndodh më asnjëhere që dikush me ja tret vetit mi ndërru vendimet e KQZ-së, sepse ato duhet të implementohen qysh i merr KQZ-ja. Të vetmën drejt për ta ndërruar ka vet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe jo dikush tjetër.

Ilir Gashi: Atëherë, kemi një kërkesë më specifike nga Eshrefi që po thotë m'i tërheq procesverbalet për ti lanë në mbledhjet e radhës për shkak se nuk ka pasur mundësi për ti trajtuar.

Ilir Gashi: Faleminderit Bajram. Atëherë, siç po shihet disponimi për shkak se ka edhe shumë procesverbale edhe ka disa vërejtje rreth tyre unë mendoj që sekretariati le ti tërheq mbrapa ti trajtoj më mirë dhe nëse ka mundësi pjesë pjesë ti sjell që mos të vijnë kaq grumbull deri atëhere edhe antarët kanë mundësi ti shqyrtojnë të gjitha dhe ti miratojnë. Me këto propozime.

Anëtarët e KQZ-së, nuk i aprovuan procesverbalet e këtyr mbledhjeve.

Enis Halimi: Kryesues, nëse nuk bëhem i tepërt e keni edhe një informatë, nëse doni me ju referuar aktiviteteteve të Sekretariatit në disa pika kryesore. Kemi harruar të bisedojmë si pikë, kërkojm falje... Për sa i takon votimit jashtë Kosovës, trajnimin, listës preliminare të votuesve...

Ilir Gashi: Po e konsumojmë në fillim se, është edhe me interes...

Eshref Vishi: Edhe një plotësim e kam tek pika e rendit të ditës tek Këshilli i Buxhetit, duhet të shtohet “shqyrtimi vjetor të shpenzimeve”, jo “shqyrtimi vjetor të subjekteve politike, shpenzimeve politike...”!

Ilir Gashi: Po flasim konkretisht për pika të rendit të ditës, më pastaj nëse ka vërejtje në atë mënyrën si i kanë formuluar këto, mund t'i trajtojmë kur të vjen pika e veçantë...

Eshref Vishi: Kur të miratohet pika e rendit të ditës, duhet të miratohet drejt, mirë.

Sami Hamiti: Raporti është mirë, por pika e emërimit është gabim...

Bajram Ljatifi: Kur jënë në pyetje informacionet e Sekretariatit dhe të drejtorit të ZRPP-së në kohë zgjedhore, ato shkojnë “ex officio...”...Ne, e kemi këtë praktikë: sa herë që ka mbledhje, duhet të ketë edhe raporte...

Ilir Gashi: Faleminderit, pajtohem edhe ne ashtu siç janë zgjedhjet e rregullta dhe mundësia ekziston që procesverbalet dhe raportet të përgatiten me kohë. Atëherë, kush është që ne ta miratojmë këtë rend të ditës me propozimet e dalura këtu...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2. Aktivitetet e Sekretariatit

Enis Halimi: Faleminderit kryesues, të nderuar antarë. Sekretariati ka vijuar me angazhimin e vet për përmbushjen e detyrave të veta që lidhen me implementimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet lokale 2017. Për sa i takon ndërrimit të qendrave të votimit ka pasur një interesim relativisht të madh ashtu përmes ku 1419 kërkesa deri më tash për ndërrim të qendrave të votimeve janë aprovuar. Dhe këto kanë ardhur 919 përmes aplikacionit online, 500 përmes zyrave të KKZ-së, ky është një indikator që aplikacioni online gjithnjë e më shumë po fiton teren krahas në raport me metodën e vjetër që kemi pasur më herët.

Për sa i takon operacionit të votimit përmes postës për periudhën e regjistrimit deri në përfundim, pra me datën 23 gusht, gjithsej janë proceduar gjithsej 12.047 aplikacione për regjistrim prej tyre 10.063 janë aprovuar ndërsa 1.321 të rrëzuara. Këto janë vetëm rezultate preliminare për shkak se procesi si i tillë është në vijim e sipër pra edhe në kohën kur po flasim. Për sa i takon programit të trajnimit tash sikur zakonshme, është me plan operacional duke u përmbushur aktiviteti edhe në këtë dimension, ka mbaruar programi orientues i ashtuquajtur për antarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve që ka përfshirë gjithsej katër module dhe këtë trajnim e kanë ndjekur përafërsisht 300 pjesëmarrës. Gjithashtu me datën 22-23 gusht është mbajtur programi orientues për trajnerët e Komisioneve Komunale Zgjedhore, për përgjegjësit e tyre, sfidat dhe implementimin e rekomandimeve që i kemi nxjerr nga takimet që i kemi pasur.

Po ashtu, tha z. Halimi, edhe në pjesët e tjera sekretariati edhe në logjistik, resurse njerëzore në financa edhe në aspektin logjistik është duke e kryer aktivitetin e vet me qëllim që zgjedhjet ti presim sa më mirë që është e mundshme, faleminderit.

Ilir Gashi: Faleminderit kryeshef, kjo ishte një informatë nëse ka dikush me kërku informatë shtesë diçka le të urdhëron.

Betim Gjoshi: Vetëm se, ndoshta është mirë me na dërguar me shkrim...

Ilir Gashi: Në rregull faleminderit, vazhdojmë me pikën e radhës lidhur me shkresën pra për pikën që e ngriti Betimi, shkresa që është ardhur nga komuna e Vushtrrisë lidhur me numrin e asambleistëve dhe shqetësimin e tyre për këtë qështje, Betim...!

3. Shqyrtimi i shkresës nga Komunës së Vushtrresë lidhur me numrin e Asambleistëve

Betim Gjoshi: Faleminderit, ju siç e dini, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, kujtoj nenin 23 në mos gabofsha, i referohet numrit të asambleistëve, duke u bazuar në numrin e qytetarëve që sipas logjikës i bie numrin e banorëve...Duke u bazuar në këtë, ne e dimë që Kosova në regjistrimin e fundit të popullësis që e ka pasur në vitin 2011, edhe ai ka qenë i pjesshëm, s'ka qenë tërësisht i përfshirë, të paktën një komunitet... Dhe, si rezultat i tillë, kemi pasur probleme në të kaluarën me numrin e asambleistëve, na zakonisht ju kemi drejtuar Ministris së Pushtetit Lokal për numër

të asambleistëve edhe kësaj here na u ka drejtuar në fund të afatit për certifikim është vonuar shumë. Edhe ka rregulluar qështjen e katër komunave veriore, ka rritur maksimum duke bazuar edhe pse nuk ka pasur regjistrim të popullësis por një vlerësim të entit të statistikave sa duhet të ketë popullsi e ka rritur numrin e asambleistëve që për mua në rregull sepse ashtu është bazë të vlerësimit por nuk ka vepruar njejtë me gjitha komunat, e ka zvogëluar numrin e asambleistëve në komunën e Vushtrrisë për kundër që atje janë dy fshatra nuk ka pasur regjistrim të popullsisë për 174 votues që ka më pak, bazë regjistrimit fillestar Vushtrria ja ka lënë nga 38 asamblistë që ka pasur në 31.

Enti i statistikave të Kosovës po atë vit, në vitin 2011, tha z. Gjoshi, ka vlerësuar se Vushtrria ka mbi 70.000 banor, po ashtu edhe në vlerësimin e vitit 2012 që është vlerësimi i fundit, unë ju kam shpërndar në ëeb faqe konstaton që janë 71.000 mijë e ca banorë. Por edhe nëse i referohemi listës së votuesve i ka 70.000 e ca votues kështu që mendoj që komunës së Vushtrrisë ju kanë hyr në hak, nuk është përdorur kriter i njejtë edhe mendoj që ne si Komision Qendror Zgjedhor i kemi para vetës 2 rrugë, që është një fakt shumë me rëndësi është që prej 2013 nuk ka pasur asnjë regjistrim të popullësis as vlerësim 2013 as nuk ka pasur këtë numër të asambleistëve nuk ka ndodhur asnjë fakt as juridik, as politik, as teknik që do të duhej të ndërroj numri i asambleistëve të komunës së Vushtrrisë. Edhe për këtë do të thotë unë kisha menduar se ne i kemi dy rrugë, e para se ne i kemi faktet për popullsi përgjegjësi nuk jemi ne, as Ministria e Pushtetit Lokal por ëshë Agjensioni i Statistikave edhe duke u bazuar në këtë që ne nuk kemi certifikuar asnjë listë të Vushtrrisë të vazhdojmë ti certifikojmë me 38 edhe vetëm te njoftojmë Ministrin e Pushtetit Lokal ose e dyta është që ne ti drejtohem sot me një shkres Ministrisë së Pushtetit Lokal edhe Qeveris së Kosovës që nëse MPL nuk vepron atëhere Qeveria e Kosovës me marr një vendim sa i përket Komunës së Vushtrrisë duke u bazuar në këto arsytetime që unë i dhashë, të dhënat e Entit të Statistikave për vlerësimin që ka mbi 70.000 banorë, për regjistrimin e disa fshatrave atje që janë ato fshatrat atje mos të hymë me i përmend. Edhe numrin e votuesve faktin tjetër, edhe fakti i katërt që nuk ka ndodhur kurëfar ndryshimi juridik nga 2013 cilin do variant unë kisha propozuar që ne ta shqyrtojmë dhe ta marrim parasysh një vendim është urgjente kjo që po flasim tani se neve na duket punë e vogël, por për një komunë të madhe siç është Vushtrria kjo ka rëndësi jashtë zakonisht të madhe.

Unë, theksoi z. Gjoshi, e kam pritur realisht javën e kaluar që kryetarja Daka t'i drejtohet instucioneve përkatëse edhe pa këtë por ajo e ka vlerësuar që na nuk është mirë mu bo palë, edhe shqetëimet e komunës së Vushtrrisë i ka kthyer me një injorancë që ka thënë, që ju drejtohuni Ministrisë së Pushtetit Lokal edhe pse e ka par pastaj që ju kanë drejtuar me shkrim MPL-së por nuk po marrin veprime, a na jemi ai fakti i fundit na nuk mundemi me njoftuar askënd edhe me ndërruar diçka, një dit më përpara me thanë ka ndërruar numri i asambleistëve.

Illir Gashi: Faleminderit Betim, urëro Binak...

Binak Vishaj: Në zgjedhjet e 2013, ne kemi pasur numrin e asambleistëve të cilët duhet ti kishte komuna e Vushtrrisë, dhe prej 2013 deri sot nuk ka ndodhur një fakt i ri, nuk ka ndodhur diçka e re ligjore që atyre ju arsyeton veprimin që ka marr vendim me e zvogëluar numrin e asambleistëve për komunën e Vushtrrisë, atëhere mendoj se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është mirë të zgjedhim këtë rrugën e dytë të Betimit që ti drejtohem instucioneve përkatse MPL

dhe Agjensionit t'ju bashkëngjisim listën e votuesve që e ka mbi 70.000 edhe gjitha faktet e tjera përcjellse dhe t'ju lutemi që sa më shpejt sepse jemi në limitet e fundit të kohës dhe është shumë e vërtetë që komunës së Vushtrrisë pa drejtësisht po i zvogëlohet numri i ulëseve në asamble.

Mendoj, tha z. Vishi se, nuk kemi kohë shumë me humbur sepse, është nevojitur para dy ditëve, kur zonja Daka e ka pasur para vetës këtë shkresë për ta përcjell tek organet përgjegjëse, por edhe tash nuk është vonë që menjëherë sot, t'i drejtohem i instancioneve të vendit që ata ti japin vlerësimin e vet dhe ti kthehen ulëset ashtu siç kanë qenë në 2013 përshkak nuk ka ndodhur asgjë e re ligjore atje për të ndërruar realitetin me ardhur një realitet tjetër.

Ilir Gashi: Faleminderit, dikush tjetër? Urdhëro z. Hamiti.

Sami Hamiti: Faliminderit kryesues. Betimi, e elaburoi shumë mirë edhe qështjen e vendimit që ka ardhur nga qeveria në kuptimin e caktimit të anëtarëve për kuvende komunale. Është e vërtetë që është vonuar shumë por, në vonim ka mbërritur një ditë ose dy para se më ardh faktikisht periudha e përfundimit 22-shi kur duhet partit politike të dorzëjonë listat e kandidatëve. Betimi u mundua e relativizoj pak qështjen e atyre 4 komunave të veriut, unë nuk po e rrelativizoj fare. Vendimi është vonuar dhe është marr ditën e fundit pikërisht për shkak atyre komunave me të cilat në bazë të asaj qka është krijuar kanë bërë një trysni dhe në mënyrën si kanë kërkuar ju kanë vendosur. D.m.th. nuk ka, absolutisht atje nuk ka ndodhur regjistrimi i popullsis dhe kërkesa e tyre kanë qenë njëfarë forme s trysnis e shantazhit, nuk bënë të zvogëlohen numëri i asamblesitëve në Veri.

Në Vushtrri, tha z. Hamiti, kërkesa ka qenë e hershme dhe kontaktet me ministrin kanë qenë në vazhdimësi. Saktë është parë që edhe në vitin 2013 edhe në bazë të projeksioneve, vlersimeve që vijnë nga ministria, nga agjensioni i statistikave të Kosovës Vushtrria në vitin 2012 ka kaluar 70 mijë banorëshin është 71 mijë, afër 72 mijë. Sot del lista votuese 72 mijë votues d.m.th. edhe e kanë neglizhuar qështjen e Vushtrrisë në kuptimin e caktimit, dhe unë propozoj që të merrët një vendim KQZ-ë menjëherë ti drejtohet qeverisë, ministrisë të pushtetit lokal të merret vendimi dhe të kthehet numri i asamblistëve për komunën e Vushtrrisë. Dihet saktësisht se aty dy fshatra të komunitetit Serb nuk janë regjistruar, nëse është bërë një projektion një komunë tjetër pa regjistrim fare edhe është rritur ai numër i asamblistëve edhe dihet saktë që nuk ka aq banorë në përpjestimin nga është në pjesën tjetër shumicës shqiptare atëherë pse të bëhet diçka krejt legjitime që në Vushtrri ti ketë 35 plus 3 atje d.m.th. për momentin janë 31 plus 3 në të vërtetë në zgjedhjet e 2013 është 35 plus 3 që po i bjenë 38 asambleist. Mendoj që KQZ-ja duhet me marr një vendim edhe konsideroj që ministria e pushtetit lokal vendimin që e ka prurë e ka prurë të gabueshëm dhe duhet të kthehet.

Ilir Gashi: Faleminderit...Dikush tjetër...? Atëherë pasi që nuk ka folës tjetër, edhe unë personalisht e mbështes, është shqetësim real dhe konsideroj se ne duhet t'i drejtohem me një shkresë Ministrisë, ashtu siq ju propozua dhe qeverisë që kjo të trajtohet d.m.th., pasi që jemi edhe palë e kësaj...,në një farë mënyre..., ta kryjm obligimin tonë karshi interesit që ka komuna..., kështu që po e hedhë në votim:

Kush është që ne t'i drejtohem me një shkresë Ministrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën që e ka bërë Komuna e Vushtrrisë...?

Eshref Vishi: Para se të shkojmë në votim, a kemi informacione nëse komuna e Vushtrrisë ka bërë kërkesë në ministrin e pushteti lokal pasi ne nuk kemi organ kompetent cili vendosë për numrin e ulëseve në kuvendin e komunës, kompetent është ministria e pushtetit lokal nuk e di qfarë procedura ndjekin.

Betim Gjoshi: Është ligji, edhe të vetmet të dhëna i kemi ato të entit të statistikave ne nuk kemi tjera e para, e dyta, ju ka drejtuar komuna e kemi kopjen edhe ne, të njëjtën kopje na kanë sjellur edhe neve.

Illir Gashi: Atëherë e hudh në votim:

Kush është pro rreth vendimit që del nga ky diskutim?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan propozimin që KQZ t'i drejtohem me një shkresë Ministrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën e Komunës së Vushtrrisë.

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Buxhet:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transferim të mjeteve nga programi i zgjedhjeve

Eshref Vishi: Faleminderit Kryesues. Ne po lëvizim me pikat të cilat janë të propozuara edhe për këtë takim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, fillojmë me Këshillin e Buxhetit. Nën një, është shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transferim të mjeteve nga programi zgjedhor. Administrata ka kërkuar nga këshilli që të trajtoj edhe shqyrtoj dy propozime për transferë të mjeteve. Transferimet e mjeteve kërkohet të bëhet nga dy programet: nga programi i Sekretariatit dhe nga programi i Zgjedhjeve. Nga programi i Sekretariatit, te kategoria e shërbimet tjera kontraktuese duhet të merren 3100 euro dhe të transferohen te shpenzimet me vendim të gjykatave dhe regjistrim të një veture, ashtu është ndarja e bugjetore....! Nga programi i zgjedhjeve te kategoria “mallra dhe shërbime furnizim për zyre” merren 700 euro dhe transferohen te mëditjet për udhëtim jashtë vendit në shumë prej 500 euro, dhe te shpenzimet për vendimet e gjykatave, 200 euro, kryesisht për procedim në gjykatë të parashtrësive. Te programi i zgjedhjeve te investimet kapitale “projekti për Server” merren 5300 euro, ndërsa i gjithë transferi në bazë të propozimeve të administratës, është në përputhje me normat e ligjit për buxhetin, në nenin 18. Rekomandimi i këshillit, është që të miratohen këto transfere...

Illir Gashi: Faleminderit Eshref. Dikush tjetër a ka, urdhëro...!

Betim Gjoshi: Së pari, krejt çka bënë këshilli, e mbështes d.m.th., ajo nuk diskutohet por, çka mendoj unë është se, jam duke thënë vazhdimisht se vendimet nuk janë në përputhje me ato çka po i thotë për shembull, kryesuesi i këshillit në këtë rast. E para, në vendim d.m.th., përveq bazës ligjore, në fillim duhet të shkruhet se pse po e bënë këshilli d.m.th., t'i ketë tre rreshta arsytim

mbi të gjitha..., këtu po i bjen që ne, KQZ-ja po e shtijm Sekretariatit me bërë këtë. Jo, këta po na shtijn neve, ne po e marrim një vendim që të ja u lehtësojmë kërkesën e sekretariatit për mjete për këto arsye d.m.th., këto duhet t'i ketë në arsyetim. Se, me të vërtet kur e merr dikush e shikon, kjo është shumë arbitrare, se kjo mbet në fund, e gjithë kjo çka kemi bërë ne muhabete, askush nuk i dëgjon, do të thotë me shkrim nuk po përputhen vendimet që po i bëjmë, krahasuar me këto... Se, po i iket qëllimisht asaj përgjegjësis së Sekretariatit pse është ardhur deri te nevoja...Ne, e kemi bugjetin hala pa u hargjitur me miliona bugjet, e na ka ardhur nevoja në gjysmë të vitit me ba kërkesa për ndryshim...! Kjo, është mungesë e mos planifikimet të tyre, ose e shpenzimeve të papritura, ose këtë ose këtë, a duhet mi arsyetu...? Pra, duke u bazuar në kërkesën kaq në numër të këtyre, ne marrim vendim që duhet, po..., me ndërru d.m.th., kjo është logjika që duhet të ndiqet në një institucion...

Eshref Vishi: Mirë, unë ju referova përmbajtjes së kërkesës së Sekretariatit dhe shqyrtimit që e ka bërë këshilli. Nuk e kam vendimin përpara por, megjithatë ne, ende nuk e kemi marrë vendimin, kompetentë është Komisioni për të marr vendimin...Ne, e kemi këtu administratën, e kemi Sekretariatit, e kemi Kryeshefin Ekzekutiv dhe drejtorin e Financave. Ne, mund ta shqyrtojmë sepse, është edhe ajo në fazën e shqyrtimit kështu që, ne mund të marrim informacione shtesë lidhur me kërkesat e Betimit për arsyetimin e transferimeve.

Ilir Gashi: Faleminderit Eshref. Por, unë mendoj se ne mund ta miratojmë kërkesën mirëpo, unë vendimin nuk e nënshkruaj pa qenë edhe arsyetimin ashtu siq e tha, edhe Betimi.

Binak Vishaj: Duke qenë pjesë e Këshillit për Buxhet, kjo kërkesa prej Sekretariatit ka ardhur njëjtë sikur e kërky Betimi edhe po e kërkyjmë ne njëjtë. Këtu Eshrefi iu referua pikës së rendit të ditës mirëpo, në kërkesë është prej Sekretariatit që këta kërkojnë të bëhet ky tranferë i këtyre mjeteve me arsyetimin që këta e kanë , për të cilin arsyetin mund ta fusim edhe në vendim kur t'i e nënshruan pas takimit...

Betim Gjoshi: Unë nuk dua të bëjë debat por, unë këto kërkesa ju kanë ardhur juve në këshill, por në këto kërkesa nuk ka arsyetim. Lexoni pikën 3 të saj lëre që nuk është në vendim por as në kërkesë nuk ka arsyetim. Pjesa 3 e saj domosdoshmërisht kur të bëhet ndonjë lokim kërkohet të shkruhet një arsyetim pse, se kjo këtu me këtë matet performanca e njerëzve edhe puna e tyre. Pse ka ardhur deri te nevoja me bo transfer të mjeteve, se ne e kemi miratuar një buxhet. Buxheti, tha z. Gjoshi, është vendimi më i madh për një institucion d.m.th., është ligj për Kuvedin e Kosovës është ligj edhe për neve. Ne, po e marrim një vendim me ndryshuar brenda këtij ligji diqka. Unë krey me goj i thash Eshrefi i tha mirë, unë po pajtona qka po thotë këshilli por, unë nuk po i shoh në letra. Ju mendoni d.m.th. që secili që merr vendime rreth këtyre duhet ta mendoj pasojën më të rënd kur është atëherë fillojnë me dal probleme d.m.th. të shkruara në arsyetim asgjë nuk po themë vetëm të plotësohet vendimi me arsyetim edhe mundësisht këta kërkesat le ti plotësojnë dhe ti nënshkruajnë. Ne, po veprojmë siq kemi qef por, ne po ju aprovojmë kërkesat për shkak të problemeve që i kanë këta.

Eshref Vishi: Nëse i referohemi anës formale, pajtohem. Përkundrazi, përmbajtësisht unë tregova se ku duhet të mirren mjetet, dhe ku duhet të shkojnë mjete, dhe arsyet pse shkojnë atje...!

Illir Gashi: Eshref, ne po pajtohemi që ta miratojm këtë kërkesë, vendimin e të cilit do ta ketë edhe arsyetimin që ju e bëtë të cilët i përfshin ne mendim dhe pastaj e nënshkruani. Kush është pro kësaj.

Anëtarët e KQZ –së, miratuan kërkesën për transferim të mjeteve nga programi i zgjedhjeve

2. Shqyrtimi i raportit të gjashtëmujorit të shpenzimeve të KQZ-së

Illir Gashi: Vazhdojmë me pikën e radhës.

Eshref Vishi: Siç e dini, programi i Komisionit Zgjedhor të Zgjedhjeve është i organizuar dhe buxheti i Komisionit Zgjedhor është i organizuar në tri programe zgjedhore: Një, është programi i sekretariatit, dy, programi i zgjedhjeve dhe tre, fondi për mbështetje demokratike, të subjekteve politike. Totali i bugjetit për 2017 për tre programet, fillimisht është i miratuar me Njëmbëdhjetë milionë e tetëmbëdhjetë mijë euro. Me shtimin e bugjetit për shkak të zgjedhjeve dhe rritet në tre milionë e ka arritur shumë e katërmëdhjetë milionë e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqindë e njëzet e katër euro. Nëse i referohemi strukturës së shpenzimeve, rezulton se nuk kemi hecur edhe mirë me bazimin e planifikimit. Shpenzimet na paraqiten në tri kategori të Sekretariati, të programi zgjedhorë, të zgjedhjet, fondi për parti të politike, tek të totali i bugjetit për gjashtë mujorin e parë, tek struktura e bugjetit dhe përqindja, pjesëmarrja në shpenzime e cila sipas mendimit të këshillit, është e ultë, tek kategoria për mallra dhe shërbime e cila, nuk tejkalon as njëmbëdhjetë përqind... Kemi tek një tjetër, të bugjetit i shpenzuar sipas programeve në tëmbëdhjetë përqind, tek sekretariatit prapë paraqitet i njëjti problem d.m.th., kemi një nivel të ultë të shpenzimeve tek të gjitha kategoritë, sidomos tek shpenzimet kapitale të muaji i tetë i viti...Po ashtu, subvencionet janë zero, dhe shpenzimet komunale një përqindje të ultë, mallra dhe shërbime po ashtu njëzet e një përqind. Tek programi “Mbështetja e partive politike”, alokimet sipas bugjetit..., nuk kemi ngecje për arsye se ato alokohen në etapa tre mujore, gjithçka shkon në bazë të planifikimeve.

Këshilli për Bugjet, tha z. Vishi, pas shqyrtimeve të raportit konstaton se, duhet të rritet efikasiteti i punës në kuptim të përmbushjes së programit, dhe duhet të rritet në ritme më të shpejta drejtë realizimit të projekteve dhe përmbushjes së planit të punës... Si i tillë, raporti rekomandohet që të miratohet me sygjerimet dhe vërejtjet e komisionit...Ju, e keni para vetës dhe gjithësecili mund ta shpreh mendimin e vetë rreth shpenzimeve bugjetore...

Sami Hamiti: Faliminderit zotri kryesues. Së pari, raportit i shpenzimit të buxhetit që është obligim ligjorë ka ardhur me kohë...një obligim ligjorë që duhet të raportosh në gjashtëmujor...Dhe, ky raportë financiar që është totalishtë i mangët pa pjesën tjetër...Ne, po ju referohemi vetëm shifrave, shifrave nominale që i kemi këtu në letër...Raporti është “një raport njëvjeçarë” që veç ja keni ndërru shifrat...Lexojeni tekstin mirë në sa vende i këni të shkruar “gjatë këtij viti” në raportin tuaj...! Ne diskutuam, dhe ju thatë se do të vjenë raporti i shpenzimeve, e ju thatë “raporti i shpenzimeve” dhe unë thash “raporti i punës” sepse, ne duam

që të shohim se, deri ku është shkuar me planin e Prokurimit dhe me planin e Shpenzimit të Bugjetit...

Tendenca: te relacioni i zgjedhjeve ne e dimë që ajo s' mund të rritet më shumë se gjatshë mujori, dhe shpenzime të mujit të qershorit, do të thotë vijnë në gjashtë mujorin e dytë...Një shifër, tha z. Hamiti, unë e di që rritet sepse, ajo është çështje që lidhet drejtpërdrejtë me shpenzimet e zgjedhjeve, dhe pak a shumë nga puna e Sekretariatit se, janë kategori...! Problemi është se, çka është bërë me mjetet e sekretariatit, e ku jeni qindë për qindë përgjegjës...! Trendi, 43 % mallëra dhe ku është efektivisht drejtpërdrejtë puna e juaja, dhe tek investimet kapitale, e ku e keni zero... Janë dy gjëra që realishtë i keni qitë si shifra por, tek ne nuk janë të sqaruar se “pse ka ndodhë kjo...!”. Prandaj, me gjithë atë, janë shkuar gjashtë muaj dmth., me obligime ligjore në at pjesë dhe shumica e instutucionit që nvaren prej bugjetit të Kosovës kanë atë gjashtë mujor, dhe tridhjetë ditë mbasi që të kalojë gjashtëmujori dmth., ne veq jemi në fund të muajit të tetë... dhe nuk e kemi si raporte...!

Unë, tha z. Hamiti, kam vetëm shqetësime që ne do të vijmë prapë në përfundim të vitit me një shpenzim të ultë të bugjetit, po flasë për kategorit për të cilat po flasim për funksionimit të Sekretariatit, jo të zgjedhjeve, dhe kjo tregon një efektivitet të dobët...Unë dhe anëtarët e KQZ nuk kemi ndonjë rapoer se deri ku kemi mbërri në projektet të cilët i kemi aprovuar. Ku janë, bile aktivitetie e prokurimit deri ku kanë mbërri...në cilat fazë janë...? Asnjë se keni bërë me kohë, se me u ba, ato ishin shpenzuar. Keni pasur prej shkurtit e këndeje, apo jeni duke e lanë fazën e fundit...? Pse vitin e kaluar, shkuan mjetet ne sufvecit...? Kemi ble na mjete në fundë të vitit, kemi shpallur tonë kohën kur është bërë rishikimi...! Ju kam thanë keni kujdesë se, po shkojmë në fazën e përfundimit të viti fiskal...Keni ba një kontratë ku keni marrë mobile, dhe paret ju kan shkuar në sufvcit, a ju kan shkue... ? Keni hy në obligimet e këtij bugjetit...! Dikush duhet me dhanë një përgjegjësi, duhet me e lanë me mendu se, hajt se ne po hecim dhe..., këtu po përfundon kjo punë...,dmth., me shku në mënyren hajt se kalon kjo punë... Përgjegjësin, duhet me marrë, këto mjete janë edhe duhet me kqyrë me i analizu këto mjete...Në pjesën teknike të raportit nuk kamë asnjë vëretje, vetëm kqyrne se, e keni marr “copy past”...! Shifrat janë, a e keni pa sa janë kokë forta, a e keni pa krejt këto..., flasin vetë! Skeni nevojë, merrni ju edhe shkruani çka të doni dmth., ato tregojnë vetë, por unë po du me pa se pse është kështu...!

Betim Gjoshi: E falenderojë Samin për diskutimet...Kjo, mendojë që është puna, detyra dhe roli i Komisionit Qendror Zgjedhorë, domethënë edhe me mbikëqyrë edhe Sekretariatit, normal edhe me e ndihmuar punët e juaja.. Sa i përket Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por besa edhe për Qeverinë e Kuvendin..., mjaftë zemërgjerë kanë qenë në kërkesat e Sekretariatit. Planifikimet kanë qenë pa ndërhyrje, po ju siç e keni parë edhe tek mësimet e nxanuna, e kemi edhe një vlerësim të operatorit gjeneral që ka të njëjtat çështje për 3-4 vjet...Gabime të njëjta në planifikim edhe shpenzim në afate kohore. Ne, është e vërtetë që po vimë në 4 vitet e fundit të vitit, dhe i kemi të njëjtat probleme që i kemi pasur edhe në fillim të vitit! Është e vërtetë që shpenzimi i bugjetit ndërlihet me punën e instucionit, është pasqyrë e instucionit. Pënjëmend, është shqetësuese nëse na kemi ardhur ne 4 muajt e fundit dhe nuk kemi zhvilluar asnjë projekt kapital, se gjasat janë që na të hyjmë në obligime kontraktuese maksimalisht me borgje për vitin e ardhshëm. Unë, flas me letra kryeshef. Kur keni ndonjë raport tjetër me letra qe unë po bazohem

ne raportin 6 muajsh, sepse nuk më vlejnë ato arsyetimet gojore sepse, i merr era...Gjendja që e kemi na, nuk është befasi sepse, unë po e shoh punën çdo ditë, unë po i shoh mbledhjet e KQZ-së se..., sepse një Sekretariat që i mban 2 palë zgjedhje brenda 1 viti, ishte dashur KQZ-në me thirr tri here në javë me mbajt mbledhje dhe me e diskutuar edhe problemin më të vogël që paraqitet, dhe me u mundue me e zgjidh. Kështu, jo në rrugë jo formale por zyrtarisht me diskutuar për secilin problem se, jemi në disponim të sekretariatit me zhvillue këtë instucion. Vetëm se, nuk po ju shohim juve që jeni t'u dashtë të njejtën punë...Ejani çdo dite e bisedojmë për secilën temë si me e bërë më mirë....!

Ne, tha z. Gjoshi, problemet e njëjta që i kemi pasur në zgjedhjet e 2009, po e zëmë, i kemi edhe në zgjedhjet e vitet 2017. Tash po e marrim shembull: edhe më pak se 2 muaj para ditës së zgjedhjeve, ne ende nuk e kemi Informim Publik. Tetë muaj të vitit kanë shkuar, dhe nuk keni qenë në gjendje me e zgjedh një kontraktor. A e keni bërë me qëllim apo pa qëllim, unë nuk e di! Unë, ju kam thanë edhe në Shqipëri se, unë nuk hi në punët e juaja, ju i dini punët e juaja..., por ne si i patëm 3 vjet, dhe si 3 ditë, si qenë zgjedhje të rregullta si zgjedhje të jashtëzakonshme, ne të gjitha punët po i lëmë në momentin e fundit. Por, duhet të ketë një planifikim. Mos të flas që ligji të lejon planifikime 2 vjeqare, 3 vjeqare! Në përgjigjsi, ne nuk jena të përgjegjshëm në kryerjen e punëve të tona, ne jemi t'u bërë vetëm punën emergjente sa për me ekzistuar, mos të flas që s'kemi strategji... Mundohuni me rritë dinamikën...Ju kam lutur prej fillimit të vitit që ta rrisni dinamikën dhe, po e marrë shembull jo me e lënë fajtor Ministrin e Pushtetin Lokal, se kjo punë është dashur me na ra ndërmend në fillim të vitit...Ne, kërkesën vonë ju kemi dërguar për me na dhanë interpretim që kemi na zgjedhje se sa asambleist i kemi, po ne jemi vonë....!

Ju lus edhe një herë, tha z. Gjoshi që me e rritë shpenzimin edhe planifikimin e bugjetit, filloni me planifikuar bugjetin për vitin e arshëm, e muaji i fundit kur është dashur me vendos bugjetin është fundi i tetorit, 31 tetori është kur ne duhet me bërë planifikimin e bugjetit, dhe jo kur e kemi me ligj sepse, atëhere veç duhet me e dorzuar. Naeplanifikimin e bugjetit, duhet me përfunduar në tetor. Një organizatë serioze, e përfundon 9 muaj me 70% bugjetin, se kjo është edhe norma e ekonomisë. Unë nuk jam ekonomist, por e di që planifikimet në mënyrë të tillë bëhen se, dhe planifikimi i mirë e zhvillon instucionin, e mban gjallë instucionin. Ne, duhet me i krye detyrat ditore, dhe se planin e punës ju kam thanë që duhet me qenë i saktë, plani i punës duhet me qenë real, m'u përballë me kapacitetet njerëzore edhe me mundësitë reale...

Eshref Vishi: Është shumë e sigurt që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka trupat e saj që në njëfarë forme, i shqyrtojnë të gjitha dokumentacionet dhe dokumentet të cilat vijnë nga Sekretariati. Mirëpo, mbi të gjitha ajo që tha Betimi rreth planifikimeve bugjetore dhe përmbushjes së planeve të punës, është drejtpërdrejtë përgjegjsi e menagjmentit të Administratës. Menagjmenti i administratës, duke filluar prej kryeshefit, drejtorët e partamentit dhe njësitë e tjera dhe shërbimet, duhet t'i përcjellin afatet ligjore dhe duhet të procedojnë në këshille dhe komisione!! Po ashtu, duke i respektuar afatet ligjore të cilat janë të përcaktuara, pak u mbetet anëtareve të komisionit, anëtareve të këshillit në kuptim të menagjimit të përdishëm të administratës. Kjo, për më tepër i bie sikur ndërhyjmë në punët e menagjmentit nëse eventualisht, interpreton se kush është me punë dhe detyra të punës...Por, ato bëhen në forume,

në takime që i organizon komisioni dhe këshilli, kështu që menagjmenti duhet t'i ketë parasysht këto gjëra...

Betim Gjoshi: Eshref, nuk po dua me polemizuar me ty por, këshillat janë trupa të Komisionit Qendror Zgjedhor që janë filtër të KQZ-së edhe që ne domenin që e kanë e kryen edhe mbikëqyrjen e punës së sekretariatit të KQZ-së. Nëse ju themi se këta nuk po punojnë, na duhet me ju thanë që nuk është kompetencë e jona për me u përzi. Ne, jemi duke ju ndihmuar me punue, unë po ju tregoj drejt juve që u nevojitet me ju japë një rëz këtyre kur janë te planifikimi, kur janë te shpenzim: ju në fushë të bugjetit, ne në fushë të operacioneve zgjedhore, ai tjetri në fushën zgjedhore...Edhe ne për këto paguhemi, ne nuk jemi makina votimi, si votuam për si votuam kundër...Ky raport shifrat i ka të sakta, por na duhet me ndihmuar që ky raport m'u realizuar plani me kohë. Nuk mundemi me thanë nuk kemi përgjegjësi, nuk kemi kompetenca, merrni e shikoni kush bënë planifikimin e bugjetit për zgjedhje në ligj, nuk thotë Sekretariati por, është përgjegjisi e KQZ-së. Unë, e di çka po flas kur flas, e them në bazë të ligjit, jo në bazë të fjalëve...

Eshref Vishi: Ta ndajmë përgjegjisin nga përgjegjësia kryesore në procedimin e materialeve dhe shkresave. Administrata dhe menagjmenti i procedon me kohë, e drejtë e jona është për me mbikëqyrë dhe me dhanë vërejtje...

Ilir Gashi: Atëhere, kush është për ose kundër që, ky raport të miratohet...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan raportin e gjashtëmujorit të shpenzimeve të KQZ-së

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të subjekteve politike të viti 2016

Ilir Gashi: Vazhdojmë me pikën tret "Shqyrtimi i raportit vjetor të subjekteve politike për vitin 2016".

Eshref Vishi: Sa i përket shqyrtimit të raportit vjetor, financimi i subjekteve politike e kemi një raport, i cili ka ardhur nga Sekretariati, konkretisht nga ZRPP: Programi për mbështetjen e subjekteve politike, në bazë të ligjit të buxhetit të Kosovës për vitin 2016. Është ndarë shuma prej 4200 000 eurove. Kjo shumë, është shpërndarë në bazë të numërit të deputeteve të cilët, përfitojnë mjete financiare nga fondi. Buxheti, ndahet për financimin e subjekteve politike, është i njëjtë nga vitet paraprake. Shpërndarja e fonve, është bërë në përputhje me ligjin, duke përfshirë edhe shpërndarjen e 10% i cili është alokuar për aktivitetin e grupeve parlamentare, ndërsa pjesa tjetër për subjektet politike. Në bazë të raportit shihet se të gjitha alokimet e mjeteve janë bërë në përputhje me ligjin dhe në përputhje me afatet kohore për alokimin e tyre. I propozoj KQZ-së që të bëhet miratimit i këtij raport.

Ilir Gashi: Faleminderit. Urdhëro, Sami!

Sami Hamiti: A ka ndonjë afat ligjorë, se kur duhet të bëhet ky raport?

Miradije Mavriqi: Me ligj, është e caktuar deri në fund të qershorit.

Sami Hamiti: Tash jemi në gusht. Kur shkon në kuvend. Shpenzimet kanë ndodhur me 31.12.2016, i keni alokuar çdo cent dhe ky është raport formal që i keni qitë mjetet dhe bëni afatet ligjore, këtë që po e thotë Eshrefi. Problemi është, se në fund se fund të gushtit, janë shpenzuar edhe dy 6 mujore. Ato parti, i shpenzojnë edhe 42 milion. Qysh i qitni, mos u brengosni, letrat ua sjellin... Problemi është se raporti është vonë. I ke dy 6 mujorë që u kanë shkuar....

Betim Gjoshi: E mora një konfirmim nga Sekretariati se, ia kanë dërguar Kuvendit para dy muajve, e na kanë sjellë neve sot! Ky raport, e ka një të mirë, që e kanë shpenzuar partitë dhe, me ua pas dhanë 42 milion u gjajnë vend ata. Nuk janë sikur ne. E para, ky raport nëse i dërgohet kuvendit të Kosovës, nuk është shkuar cdo gjë mirë. Kjo, është problem. Dhe, është dashur me i shkruar në raport. Edhe një ligj i financave të partive politike është katastrofë. Është i formuluar për një situatë që është krijuar në Kuvend të Kosovës, ku dy prej grupeve parlamentare nuk kanë qenë parti politike. Paratë jepen për parti, e për me iu dhanë atyre pare pa rregullativë është bërë. Është i dizajnuar gabimisht, dhe është dasht me u bë vëretje, s'keni ditë kujna me ja dhanë paret se, keni pas probleme jashtëzakonisht shumë...Ju e dini me subjekte politike, na i dim të gjitha dhe është dashtë me i paraqitë ligjet edhe Kuvend, dhe kur te sheh raportin duhet për me e pasur parasysh mandej, edhe ju e dini që e kan pasur atë pjesën në grupe parlamentare që thotë se secilit deputet i takon.. Edhe ata e keni problem, dmth., edhe ata është dashtë me i shti si raport edhe qitë pjesë...Për qata e ka atë hymjen, dhe është dasht me i vlersu...Unë, e kam thanë disa herë... Qe, po jua përmendi edhe njëherë fondin për parti politike, dhe kurrfarë rregullash as për parti dhe as per grupe parlamentare nuk janë bërë, po e marrim për shembull faktin se, pse ne s'po i shtijmë partit politike...

Me respektu ligjin e prokurimit dhe duke i marrë paret e bugjetit të Kosovës, tha z. Gjoshi, ne është dashur me i shti rregullativat dhe, këto janë punët tona...Por, ata seriozisht, nuk kishin mundur me 9.99% të bugjetit se..., ishte dashur me i ba procedura e prokurimit dhe me i respektuar ato, sidomos kur janë në pyetje blerjet e ndryshme...! Ne, nëse vazhdojmë me mendue që “këto s'janë punët tona se, po themi vazhdimisht se kjo s'është punë e jona dhe, ajo s'është e jona....!” Për problemet që ju i keni pasur, edhe është dashtë me i kqyr këto gabime...Unë, moti e kam pritë një rregullore për nisma qytetare, moti kam pritë një rregullore për punët e fondit të partive politike, moti e kam pritë një rregullore për fonde zgjedhore se mundeni me i pritë njerzit, e nuk keni infrastruktur ligjore...! S'mundemi me thanë se të gjitha këto nuk janë punë tona...

Ilir Gashi: Deshta me shtue këtu se, në këtë pjesë, sa i përket grupeve parlamentare në zhvillim dhe procedura të prokurimit, le ta shfrytëzojnë procedurën e prokurimit të Kuvendit të Kosovës...! Sa i përket kësaj çështje, ndërsa për qështje të tjera jamë dakord plotësisht. A ka dikush tjetër me shtu diçka rreth kësaj...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan raportin vjetor të subjekteve politike të viti 2016

4. Propozim - ndryshimin i vendimit për mbushje të telefonisë mobile për zgjedhje lokale 2017

Eshref Vishi: Është kërkuar, me qëllim të harmonizimit të vendimit të mbushjes të telefonisë mobile gjatë procesit zgjedhorë e me udhëzimin administrativ...! Është ngrit kjo çështje për arsye se, kanë gjetë shpërputhje për disa pozita zyrtare që marrin mbushje telefoni në kundërshtim me dispozitat e vendimit të këtillë, dhe për këtë arsye propozuesi e ka ngritë këtë çështje që, të plotësohet edhe të ndryshohet me harmonizimin me udhëzimin administrativ. Për ma tepër, nëse kërkohet se në cilat pozita ka shpërputhje, atëherë është sekretari, është propozuesi...Binaku, është propozues

Binak Vishaj: Ka mbetë që Sekretariati me bërë harmonizimin dhe me i trajtue se cilat janë ato pozita që nuk janë trajtuar në bazë të udhëzimit administrativë, dhe cilat janë ato pozita që kanë marr mbushje 200%, kështu që nuk po i hijmë pozicione të caktuara, kështu që ka mbetur që këta me i harmonizu qëndrimet dhe me u trajtuar në mënyrë të barabartë...

Betim Gjoshi: E para, ne nuk kemi pasur tabelë kur i kena miratu...Vendimi i KQZ-së ka qenë njejtë, me ua rritë dyfishë atyre që marrin mbushje...Kjo ka qenë..., dhe është diskutuar por, dikujt nuk ju ka zbatuar ky vendim...! Nuk kemi pasur formë të shkruar... Nuk mund ta sfidojmë sekretariatin në këtë mënyrë...Shtesa është bërë dyfish për shkak të procesit zgjedhorë...Nëse këta kanë bërë gabime, le t'i përmirësojnë këta...!

Binak Vishi: Edhe unë deshta me e thanë këtë konkretisht , e që me u trajtue në mënyrë të barabartë të gjitha pozicionet..., në bazë të udhëzimit që i kemi marrë. Dhe, në bazë të këtyre shqetësimeve që i kam ngritur për disa çështje, është gjetur e nevojshme që ka pasur nevojë për trajtim të veçantë për disa pozita, e që është dyfishi që na e kemi lejuar...Besoj se, tash është bërë harmonizimi dhe në bazë të vendimit të procedohet më tej...

Betim Gjoshi: A po më lejoni ta lexojë se, çka keni shkruar në vendim...? Më vjen keq por, nuk mund të votojë për gjithëçka: “Ndryshohet vendimi 1, 2, 3 edhe 6 për mbushje shtesë e telefonisë mobile për stafin e KQZ-së dhe trupat menagjuese të zgjedhjeve. Mbushjet shtesë ndahen për muajt shtator, tetor, nëntor, dhjetor...,ndahen sipas tabelave të bashkangjitur të administrimit të telefonisë mobile...Ljohet sekretariati që ta zbatojë vendimin...”. Sipas kësaj, vazhdohet me mbushjet që janë në udhëzim...Dhe ne për udhëzim, nuk kemi nevojë me marrë vendim...Nëse doni me rritë, me ndryshu me 100% shumën, shkruani saktë dhe kjo i bjen dyfishi... Gjithmonë mendoni që keni me u përballë me dikend, me auditorin...pra, kjo mbetet dhe jo ajo se çka kemi folë në korridore...

Illir Gashi: Falimnderit, atëherë a pajtohenit që të riformulohet vendimi...? Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, vendosën për ndryshim dhe plotësim të vendimit për mbushjet e telefonisë mobile për Zgjedhje Lokale 2017 me një votë abstenimi (Betim Gjoshi).

5. Këshilli për Operacione Zgjedhore:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit për vula të fletëvotimeve

Eshref Vishi: Mos të zgatim më shumë, dhe vazhdojmë me pikat e tjera të cilat janë shqyrtu në Këshillin e Operacioneve Zgjedhore dhe ju kan rekomanduar KQZ-së për me i miratuar...Tani, e bëjmë shqyrtimin dhe miratimi i dizajnit për vulat e Fletëvotimeve...Nga administrata, kan rrjedh dy apo tri propozime për dizajnin e vulave të fletëvotimit...Ju, e keni para vetës një formë të cilin e ka rekomanduar KOZ-i me përmbatje të numrit të kodit të komunës edhe të fletvotimit. Me sa di unë, ashtu është edhe përmbajta e dytë me vulënn rezervë me të cilin duhet të perdoret në procesin zgjedhor të Zgjedhjeve Lokale.

Me propozimin e KOZ-it, tha z. Vishi, numri i vulave rezervë të jetë në përqindje të reduktume, mos të jetë në çdo vendëvotim..., por të jetë një vulë vetëm me kodin e komunës në përmbatjen e sajë, vetëm nëse eventualisht paraqitet nevoja në rast të dëmtimit të vulës së fletëvotimit në vendin përkatës, ose mungesës së saj... Dhe për këtë çështje të hapet diskutimi dhe të flasim këtu....

Enis Halimi: Ideja është se Sekretariati e ka rekomandu për këshill por, ajo çka kisha me thanë është se vula që është material, bëhet material i ndishem në moment ku procedohet me tutje d.m.th, ne i kemi edhe disa karakteristika të sigurisë që i ruajm në kuptim të konfidencialiteti në mënyr që mos të vije deri tek ajo që askush nuk e dëshiron dhe të manipulohet si një material i ndishëm...

Ilir Gashi: Faliminderit kreshef...E e hapim diskutimin...Urdhëro Betim...

Betim Gjoshi: Edhe unë pajtohem me atë që tha kryeshefi..., por ne është dashur ti kemi disa të dhëna më shumë se kjo që është: dizajni...! e param “Fi” sa është, e dyta, sa është madhësia e saj, rrezja edhe dimateri dhe e treta, a është e emplimentushme...? Për mua, është e ngarkume dhe nuk e menojë që kjo mundet me u qitë dhe, me u marue e me u lexue... Se kjo, nuk marohet kaq (ai, analizoi formatin, shkronjat, diametrin dhe elementet e tjera të vulës...).

Provoni se, a është e implementueshme kjo si vulë...! Pra, mos na detyroni me marrë vendime po, provojeni a është valide..., a funksionon...!

Ercan Spat: Si informat shtesë: anëtari shtesë e dha arsytimin por ne në KOZ, diskutuam edhe specifikat tjera të cilat, kolegu Betim i përmendi...dimatrin 40 milimetra etj.

IlirGashi: Faliminderit. Ne, mundë të shkojmë ose ta konstatojmë dhe t’i japim të drejtën Sekretariatit që këtë vulë, dhe jo vetëm vulat por edhe ngjyra, jastëku, dizajni dhe specifikacionet e tjera...

Anëtarët e KOZ-së, miratuan dizajnie për vula të fletëvotimeve me disa ndryshime dhe plotësime të nevojshme.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Formës së Përputhjes së të Dhënave (FPR)

Eshref Vishi: Si pikë tjetër e cila është shqyrtuar në KOZ, është edhe Formolari i Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve... formular i cili ka pësuar ndryshime nga formulari standar i deritanishëm... Është një propozim ma i thjeshtuar dhe administrata e cila ka punuar së bashku me IFES-in, ka ardhur në përfundim se kjo, do të ishte forma ma ideale që zbatohet në zgjedhjet që i kemi përpara... Unë, po e jap vetëm një kërkesë nga administrata nëse eventualisht, janë plotësuar të gjitha vëretjet të cilat KOZ-i i ka dhënë...dhe, ato konsistuar te pjesa e fundit e shënimit të të shiritave të kutisë së votimit të cilat, nuk kanë qenë udhëzimet se çka duhet të shënohet, këtu, poshtë...Po ashtu, është edhe rubrika e 10 –të: “Numrit të fletëvotimeve të paplotësuara”, që e ka kuptimin e numrit të fletëvotimeve të paplotësuara në kuti...! Dhe, është që të shënohet në kuti këtu, në mënyrë që të dallohet nga numri i fletëvotimeve të zbrazëta... Pra, mos të ketë dilemë se antarët e KVV-së, çfarë duhet të shënojnë në këtë rubrikë...

Bajram Ljatifi: Mendoj që kjo pjesë, duhet të përmbajë informacione të paplotësuara, bëhet fjalë për fletëvotimet që mbahen në kuti...Fletëvotimet që mbahen, janë fletëvotime të pashfrytëzuara...Këtu duhet t’ a bëjmë dallimin: fletëvotimet që nuk janë plotësuar, dhe ato që janë shkuar në kuti...Kurse këtu, janë ato që nuk shfrytëzohen fare..., dhe këtu janë të lidhura, dhe këtu jepen shifrat, numrat: shembulli prej këtij numri, deri te ky numër...! Dhe, kështu nxirren informacionet...

Betim Gjoshi: Mendoj që një hap është bërë reth kësaj..., pavarësisht se ne kemi bërë vëretjtje vazhdimisht se ka një kallabllak rubrika...Unë, i qëndroj propozimit se ne, duhet të bëjmë dy lloj formularë, do të thotë për vendëvotimet e rregullta të dyfishta..., i kena 2000 vendvotime të rregullta, e nja 900 të dyfishta, edhe nuk mundemi për 900 të dyfishta me i dërgue 2900 formular me ngarkesë sepse kjo i ngatërron... Dhe, mendojë që kjo e kish zgjidh problemin jashtë zakonisht shumë, e kish ba ma të lehtë për kryesuesit edhe komisionerët se, atëhere, nuk do t’i kishim një, dy, tri, katër ose pesë rubrika...Mangut, i bie që ishin mbetur vetëm 10 rubrika, e paramendoni sa lehtë i bie që nga 21, kishin mbetur vetëm 10 rubrika me i mbushë...

Fletëvotim i zbrazët, është fletëvotim kur nuk plotësohet nga votuesi, ligji e njëhë si kategori por, s’ka çka me u hamend askush, është fletëvotim i pa plotësuar dhe pikë. Se di pse s’po kuptohemi ...Pra, mendoj që ne ish dashtë me i pasë dy formularë sepse, kishim ardhë më lehtë deri te saktësia saktësia më e madhe e tyre...

Bajram Ljatifi: Mendoj që ligji është i qartë...Neni 106.4, f...”Numri i papërdorur i fletëvotimeve dhe, numri i fletëvotimeve të zbrazëta...” Dy lloje janë...

Burim Ahmetaj, koordinator i QNR-së: Faleminderit kryesues, e implementueshëm është...S’ka kurrëfarë dileme...Mirëpo, nëse bëhen dy versione, njëra referohet e rregullt dhe tjetra referohet veç vendvotim i dyfishtë. Mirëpo, nuk ta jep fleksibilitetin te trajnimi që momentin e fundit

kryesuesi apo antarët e këshillit të vendvotimit mundën me u ndërruar, kështu që na duhet në këto raste me ba trajnime të veçanta, e që ndoshta edhe në momentin e fundit edhe ndërrohen antarët e këshillit dhe antarët e KKV-së. Faktikisht, nëse flitet kishte me qenë mirë të flitet për të rregullta, por nuk janë trajnuar në asnjë mënyrë nuk janë trajnuar ndaras, e nëse flasim ndaras për këto të rregullta apo të dyfishta vetëm te pjesa e trajnimit, është se përndryshe është e implementueshme se ...Nuk ka kurrfarë pengese të implementimit, e bashkë me këtë e kemi parapa..., do t'ja japim edhe si një aneks të shpjegohet për secilën rubrikë...Para veti, e keni bashkë me formularët e rezultateve, mirëpo për mendim tim, ndoshta ma mirë ka qenë vetëm një formular...Prapë po them, është mendim im personal të ketë fleksibilitet në zëvendësimet në trajnim...se, nuk ka ndonjë pengesë që të bëhen veç në të pa rregulltat, ose veç për të dy fishta....

Ercan Spat: Tash, pas sqarimit të Burimit diskutim tjetër, na edhe në këshill e kishim diskutim. Sinqerisht mund të jetë edhe botërisht, nuk kemi çka me fsheh prej njëri tjetrit. Njeri që është i mishëruar me procesin zgjedhor nuk ishte dje në KOZ, por prapë në këto aspekte e diskutuam, dhe prej të gjithë anëtarve të këshillit, mbeti ky qëndrim që t'i propozohet KQZ-së ky versioni që e keni para. Pasi që e mora fjalën desha po e tërheq vërejtjen, kuptoj sekretariatit se a kanë bërë me qfarë qëllim, por një qështje që e kam iniciuar më herët po më duket se nuk është marr asgjë para vetit keni një mostër i cili e ka komunën ku është sipas ligjit për përdorimin e dy gjuhësi, në faqen e parë është ashtu por në faqet e tjera Sekretariati për me na mundësuar me pa qysh do të duket, dy here e ka shkruar në gjuhën shqipe...Shqipja është dy herë...

Ilir Gashi: Faleminderit, tash e kemi një pikë tjetër, me këto ndryshimet që u thanë. Kush është pro...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Formën e Përputhjes së të Dhënave (FPR)

Ilir Gashi: Eshref vazhdojmë me pikën e radhës.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më datën 11 qershor 2017

Eshref Vishi: Pika e radhës, ka të bëjë me shqyrtimin e miratimin e asgjësimin e materialit zgjedhor të zgjedhjeve të Jashtë zakonshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me 11 qershor 2017. E keni vendimin para vetës, besoj se e keni lexuar..., fjala është për asgjësimin e materialit zgjedhor për zgjedhjet që kaluan... Ne, e kemi shqyrtuar këtë vendim dhe jemi ndal pak më tepër tek pika e pestë, tek kutia e votimit të cilat janë rinumëruar me vendim të KQZ-së në QNR...dhe, ato do të ruhen deri në një vendim tjetër të KQZ-së...! Kjo, ishte kërkesa jonë që të ndryshohet në këtë formë të cilën e keni para vetës, ky paragraf...

Ilir Gashi: Faleminderit Eshref për diskutimin. A ka dikush për këtë qështje? Atëhere kush është për rekomandimin e këshillit? Faleminderit.

Betim Gjoshi: Një temë që lidhet me të dhënat, mirë është me diskutuar se na po i shkatërojmë këto databazat fizike, po për ato elektronike a keni menduar ndonjëgjë, çka shkatëroni prej saj, a

mundeni me na sqaruar...? Është mirë me menduar ju se e plotëson këtë kushtin formal një vendim, mendoni më gjon.

Enis Halimi: E kemi diskutuar këtë për mbrojtjen e të dhënave personale, kemi caktuar zyrtarin tonë që merret me atë punë...Kemi punuar konkretisht në 2014, tash në 2017 nuk është se kemi diskutuar....Jemi në një proces të implementuar...

Ilir Gashi: Faleminderit kryeshef. Vazhdojmë me pikën e radhës, që është propozimi që e bëri Binaku lidhur me një vendim të KQZ-së sa i përket udhëtimit në Londër.

Binak Vishi: Faleminderit kryesues, më vjen keq që duhet me ngrit në këtë masë, por mendoj që KQZ-ja e ka kryer punën e vet. Ka marr vendimin, të cilin vendim është obliguar me implementuar, mirëpo vendimi me datën 17.08.2017 që ka marr KQZ-ja për përmbajtje kush udhëton për kohën se ku udhëtojnë. Vendimi tjetër është nënshkruar në data të ndryshme që është në kundërshtim me vendimin e KQZ-së, do të thotë për këtë e kam ngritur këtë qështje në KQZ dhe me tërheq vërejtjen kryeshefit që mos me ndodh që të formulohen më vendimet të cilat nuk janë në harmoni me vendimet që i ka marr KQZ-ja në takim dhe tash unë nuk e di cilat, dhe nuk e di cila rrugë e ka marr vendimin KQZ-ja. Veç e di që ka nevojë ky vendim implementohet procedurat që kanë implikime edhe buxhetore për këtë arsye e kam qit që me trajtuar në KQZ, ta marrim një vendim dhe ta zgjidhim këtë kjo praktika që dikush ti jep vetit drejt për mi ndërru vendimet e KQZ-së të mbaroj. KQZ-ja është që i merr vendimet dhe i ndryshon vendimet e veta jo dikush tjetër në mënyr individuale, më vjen keq që duket me ngrit kështu por nuk ka pasur punë tjetër veç këtu me pru.

Ilir Gashi: Faleminderit Binak. Unë kisha dashur një përgjigje nga Xhema..., ndoshta me na tregu se nuk e dimë saktë vendimi paraprak që është nxjerr në bazë të procesverbalit dhe cili ka qenë vendimi i saktë që ka marr KQZ-ja rreth kësaj dhe a ka pasur data të caktuara edhe pse ajo po dihet. Dhe më pastaj konsideroj që duhet ta bëjmë të qartë pa marr ndonjë vendim.

Enis Halimi: Në parim, vendimet që merren në KQZ nuk i nënshkruaj unë por kryetarja e KQZ-së. Por ato vendime ndryshojnë vetëm në atë vendim që dakordohet komisioni si i tillë, për këtë rast në ngjarje kemi menduar që vendimi derisa është problematizua qështja, është nënshkruar ashtu edhe si është marr.

Ilir Gashi: Unë po mendoj..., përgjigjet nga ata që i formulojnë vendimet dhe vendimet e KQZ-së formulohen mbi bazën e një procesverbali që ne e kemi diskutuar këtu dhe po mendoj se është mirë Xhema me na dhanë përgjigje: qysh ka qenë vendimi i parë, cilat kanë qenë datat edhe ne pastaj, e kemi shumë të lehtë këtë punë. Urdhëro...

Betim Gjoshi: Mua po më vjen keq që po bisedojmë për një temë që nuk është dashur me biseduar e para. E dyta, është mirë m'u bo pak ma real me diskutuar temat në shumë aspekte, po na e kemi pasur një vendim së pari për 12 veta për të shkuar në Londër, ëshë mirë me shikuar ai vendim qfarë data ka pasur. E vetmja here që kemi pasur agjendë në KQZ ka qenë ai vendim, herën e dyt që e kemi marrë e lexova procesverbalin e asaj mbledhje nuk është përend data të jemi real nuk ka pasur datë. Është diskutuar me shkurtuar ditë, trajtoni mi shqyrtuar mirë, mos i boni presion as administratës as askujt kemi marr vendim në ditët e fundit edhe nuk kemi vendos

në cilën ditë me shkuar të jemi të qartë nuk ka diskutuar askush për datë, është diskutuar për njerëz se brenda 12 kush do qoftë që shkon e lexova edhe një here diskutimin nuk kemi pasur ndonjë agjendë para vetës mund të ketë pasur draft vendim mund të mos ketë pasur por na nuk e kemi parë. E vetmja shkresë ka qenë një shkresë që ju ka drejtuar personi nga organizata që e ka sponsoruar takimin që ka thanë që është mirë me shkuar se takimet janë caktuar. Mos u bazoni që ka pasur datë apo jo, se Xhema ju qiti në atë a e financon apo jo të jemi të qartë na e kemi marr një vendim për herën e parë ka qenë e sakt data 17 deri me 21 për atë kemi diskutuar herën e parë, herën e dytë nuk është diskutuar për data.

Sami Hamiti: Na po flasim për një esencë, për një vendim që ka marr KQZ-ja. Nëse kemi biseduar kemi marr një qëndrim që është prej 17 deri me 21... Është dashur m'u marr një vendim tjetër, por këtë që po thotë Betimi nuk e dimë a është e sigurt, a do të vjen Valdetja. Thënë të drejtën, ne po e diskutojmë, unë se kam ditur a është i 17..., më ka dal prej mendjes, qëndrimi prej 17, bash me shikuar vendimin se a është i 17, nëse ka qenë 18 veç një anshëm se..., se dikujt dëshiron me ju shkurtuar..., nuk është reale. Betimi e paska lexuar, nuk paskemi folur për data sigurisht nuk kemi folur po nëse vendos një here është dashur të merret m'u diskutuar...

Betim Gjoshi: Jo vetëm datat por, kanë qenë edhe agjendat ditore, dhe kemi vendos 17 deri me 21, herën e dytë është dashur m'u shkru vendimi e pastaj, është dashur me shkurtuar delegacionin për këtë se kanë shënuar vendimin. Këtu, ka fajtor shumë dhe mos u mundoni me gjetë vetëm një, më mirë me marr vendim me shtuar një dit ose me thanë vendimi është prej 17 deri me 21 edhe mos lodhemi mu mundu.

Ilir Gashi: Unë në bazë informatave që kam parë, Xhema duhet me qenë shumë i singertë..., ma herët tha po është në procesverbal, e dyta, unë kam njohuri ...,vendimin ia ke dërguar me nënshkru 17 deri më 21, por nuk e ka nënshkruar. Ku është bazuar, unë dua me ditë ku është bazuar ai që e ka dërguar dhe nuk e ka nënshkruar vendimin, vetëm këtë...

Eshref Vishi: Gjërat janë shumë të qarta, unë po ju besoj këtyre dy shkresave që i ka pasur Binaku. Atëhere nëse themi se nuk është caktuar data e sakt, cila arsye ka shty administratën me shkruar datën 17, pse nga e murr këtë datë 17 deri në 21. Tjetra, asnjë akt që zbatohet në KQZ nuk i jep të drejt që të lëviz me dispozitetin ose me vendimmarrje jashtë asaj që ngritët dora këtu dhe miratohet. Kur del nga këtu nuk ka mundësi me ndryshuar asnjë datë asnjë germë asnjë pikë asnjë presje, dhe mbi këtë bazë është mirë të jemi korrekt dhe ju si administatë dhe na si komision, mos të manipulojmë me shkresa se nuk është formalisht as poceduralisht as ligjërisht.

Binak Vishaj: A marrim vendim: 17 deri me 21, vendim i ri duhet me qenë sot... E ki vendimin e ri, është kryesuesi, e nënshkruan...

Betim Gjoshi: KQZ-ja ka marr vendim për këtë qështje para 2 muaj ditëve. Ka disa fakte, ka një agjendë një plan përpara, ka vendos data 17 deri me 21 për arsye se kemi pasur me na financiar dikush tjetër. Mungesë financave kemi dashur ta anulojmë krejt, por na kanë bërë kërkes ata sponsorët the kanë thanë është jo serioze me anuluar, edhe është sjell vendim me shkurtuar delegacionin. Problemi është herën e par nuk kanë bërë vendim, nuk ka vendim të shkruar se kishim marr vendim me ndryshuar atë vendim me zvogëluar delegacionin. Herën e dytë nuk ju

ka ra ndërmend me folë për datë, dhe askush nuk ka folur për datë, edhe kryetarja është bazuar pasi po e financojmë vet po largojmë një ditë, vendim nuk ka pasur të jemi të qartë.

Ilir Gashi: Kemi një propozim konkret, ne duhet të vendosim në bazë të asaj që ka qenë herën e parë për shkakë se në vendimin e fundit, është harruar me u vendosë data...Kush është që ky vendim të mbaj datat: 17 - 21 për udhëtimin në Londër...?

Betim Gjoshi: Vetëm edhe një gjë: A e kemi futë këtë pikë në rend të ditës, apo jemi duke folur në të ndryshme...?

Ilir Gashi: Po, e kemi në rend të ditës...! Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesën që vendimi për udhëtim në Londër, të mbajë datat: 17 – 21...

6. Të ndryshme

Ercan Spat: Po, unë e kam një kërkesë prej kolegëve antarë të KQZ-së që ta diskutojmë dhe të marim një qëndrim lidhur me një çështje, me të cilin u befasova...! Unë, sinqerisht jurist nuk jam, ju e dini...Por, tek unë ka ardhur një pale, një kandidat i zgjedhjeve lokale...Ne, certifikimin ende se kemi bërë, dhe ai ka ardhur me kërkesë për me u tërheqë...U konsultova me Zyren por, ata më thanë se nuk ekziston mundësia e tërheqjes së kandidatit pa prezencën ose pa nënshkrimin e nënshkruesit të Listës së partisë për të cilin kandidohet...E cilat janë shkaqet për tërheqjen e njerzëve, mos knaqësitë, mospajtimet dhe..., qysh mundemi na si institucion, zyrja jonë me e bindë një parti.... Me e marrë përkrahjen lidhur me palën që po kërkon me u tërheqë...

Ilir Gashi: Faliminderit Ercan, po më duket e pa nevojshme kjo punë e tërheqjes...! Deri në certifikim, kur të dëshiron mundet me u tërheqë...!

Miradie Mavriqi: Faliminderit, deshta vetëm një sqarim...Ne, kur e kërkojmë dokumentacionin e subjeteve politike ose të kandidatëve të tyre, e sjellin vetë subjektet politike: edhe në listat e tyre, edhe në formë elektronike, edhe një kopje e fortë e nënshkuar prej kryetarit..., kuptohet, në ndërkoh nëse ka ndonjë gabim në ato dokumentacione, atëherë ne i njoftojmë subjektet politike...

Ne, nuk ndyrshojmë dhe as plotësojmë listat e partive..., pa konsultim me subjektet...Z. Erxhan, ka ardhur me kandidatin i cili, ka thënë se po tërhiqet nga subjekti, me kaluar në subjekt tjetër...Ne, nuk prekim listat e subjeteve politike, nuk e kemi atë të drejtë...

Betim Gjoshi: Kjo procedurë është e thjeshtë, më e thjeshtë s'ka ku shkon hiq, veq nuk është bash qysh po thotë dretoresha...E para, kandidimi dhe tërheqja e kandidatit deri kur I jepë të drejtë ligji, është e drejtë e kandidatit...Ai, mundet me ardhë me u tërheqë, ti e njofton subjektin politik se, "kandidati" ka dhënë dorëheqje nga lista jote...E, për me hi në listë, kjo është temë krejt tjetër... Janë procedurat që e rregullon, por me e ndaluar ti s'mundesh me e

ndalue...Subjekti e ka kuotën, dhe ai mundet me e zëvendësue pa asnjë problem...Kemi pasur kësi raste...Janë arsytet e ndryshme se për çka tërhiqen...Ne, s'kemi kurrëfarë të drejte me e ndalue...Ne, ende se kemi bërë certifikimin...! Ju lutem, referojuni ligjeve..

Ercan Spat: Unë isha i qartë...Një palë ka ardhur që të bëj një terheqje, s'ka lidhje me tjetër gjë...

Ilir Gashi: Ne, as nuk mundemi me e futur në listë nëse, ai kërkon tërheqjen por, vetëm duhet me u njoftue subjekti...

Për KQZ

Ilir Gashi, anëtar
